



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:205268

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06707934

C.nr.3478/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.M., nga fshati G., Komuna e P., të cilën e përfaqëson A.L., avokat nga P., kundër të paditurit K.M., nga fshati N., Komuna e F. K., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 14.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditëses M.M., nga fshati G., Komuna e P., në këtë çështje juridike kontestimore, kundër të paditurit K.M., nga fshati N., Komuna e F.K., me shenjën C.nr.3478/2014, e datës 23.12.2014.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë, më datë 23.12.2014, ka ushtruar padi kundër të paditurit K.M., nga fshati N., Komuna e F.K., për kompensim dëmi material dhe jo material.

Gjykata me aktvendim me shenjën C.nr.3478/2014, të datës 25.11.2024, e ka detyruar paditësen për deponimin e mjeteve në emër të paradhënies për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, po ashtu është njoftuar se gjykata do ta hedhë poshtë padinë nëse brenda afatit kohor prej 7 ditësh, nuk i'a dorëzon gjykatës dëshminë se është bërë deponimi i mjeteve në shumën e cekur si në aktvendimin e datës 25.11.2024.

Përfaqësuesi i paditëses aktvendimin për deponim e ka pranuar më datë 03.12.2024, që vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal e cila gjendet në shkresat e lëndës, mirëpo nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, andaj gjykata vendosi që të hedhë poshtë padinë.

Gjykata në rastin konkret nuk ka mundësi të vazhdoj tutje me padinë e paditëses, kjo për shkak se paditësja brenda afatit të caktuar ligjor nuk ka vepruar konform aktvendimit C.nr.3478/2014, të datës 25.11.2024, pra nuk ka bërë deponimin e mjeteve në emër të paradhënies për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, andaj gjykata nuk pati mundësi që të paditurit t'ia caktoj përfaqësuesin e përkohshëm, dhe si rezultat i kësaj kjo procedurë nuk pati mundësi të zhvillohet dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj meqenëse paditësja nuk ka vepruar konform nenit 391 pika g) të LPK-së, nuk ka ndërmarrë veprime për eliminimin e mangësive të konstatuara dhe nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe neni 102 par.3 e lidhur me nenin 81 par.2 të LPK-së, gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3478/2014, datë 14.01.2025

Gjyqtari  
Egzon Mujaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është lejuar Ankesa,  
në afatin prej 15 ditëve, nga marrja e të njëjtit,  
përmes kësaj gjykatë, në Gjykatën e Apelit  
në Prishtinë.